



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 520  
Nr. 520 AKTI

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

**GJYQTAR : BESNIK HOXHA**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Florinda Nushi**, me pjesëmarrjen e prokurorit Petrit Bica, sot në Tiranë me datë 21.06.2018 mori në shqyrtim kërkesën penale nr. 520 Akti që i përket

**K Ë R K U E S I:** **Izet HAXHIA, i biri Idrizit dhe Rukes, i dtl. 1966 lindur në Tropojë, aktualisht ndodhet në IEVP 302 në Tiranë, me arsim të lartë. Mbrojtur në Gjykim nga Av.Bashkim Nikolla, me prokurë.**

**O B J E K T I:** **Rivendosje në afat të ankimit, ndaj vendimit nr. 316 dt. 29.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë në ngarkim të pandehurit Izet Haxhia, lënë në fuqi nga Gjykata Apelit Tiranë me vendimin Nr.351 dt.09.07.2002.**

**Baza ligjore:** **Neni 147,148,449,450,453, te K.Pr.Penale.**

**Në përfundim gjykata pasi administroi provat, dëgjoji av. B.Nikolla dhe kërkuesin Izet Haxhia, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat; dëgjoji prokurorin P.Bica, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës sit ë pabazuar në ligj e në prova; pasi shqyrtoi çështjen në tërësi**

**V Ë R E N**

**Se, kërkuesi (i dënuari) Izet Haxhia , i është drejtuar gjykatës me kërkesen, ne të cilat kërkon rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit për vendimin nr. 316 dt. 29.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.**

**Kerkuesi Izet Haxhija, nepermjet mbrojtësit të tij të zgjedhur ka kërkuar rivendosjen në afat të ankimit kunder vendimit Nr. 316 date**

29/04/2002 të gjykates shkalles pare të rrethit gjyqësor Tirane. Si shkaqe të kërkesës kerkuesi i është referuar neneve 147,148, 450,453 te K.Pr.P. të cilat bëjnë fjale për dy element të ankimit, rivendosjen në afat dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë. Për realizimin e kësaj të drejte, kerkuesi I referohet edhe një seri dispozitash ligjore që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të drejten për tu dëgjuar nga një gjykate e pa varur, të drejten për tu njoftuar e njohur me procesin gjyqësor që zhvillohet kundër tij, të drejtën për tu informuar për vendimin që merret ndaj tij.

Rrethanat e ceshtjes:

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se: kërkuesi Izet Haxhia, është deklaruar fajtor me vendimin nr. 316 dt. 29.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “ Vrasjes me paramendim” të Azem Hajdarit kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 78/2-25 i K.Penal dhe është dënuar me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim . Eshtë deklaruar i pafajshëm për veprat penale të “Vrasjes me paramendim ndaj shtetasit Besim Cera dhe Zenel Neza. Vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tirane me vendimin Nr.351 dt.09.07.2002.

Me shkresen Nr. 4029/2 date 06/08/2002 është dërguar urdhëri i ekzekutimit të prokurorit, policise së shtetit për të arrestuar dhe dërguar prane institutit ekzekutimit vendimeve penale për të vuajtur dënimin e dhënë.

Ky gjykim në të gjitha shkallët është zhvilluar në mungesë të dënuarit (kërkuesit) Izet Haxhia, i cili ka qenë në cilësinë e të pandehurit dhe nuk ka lëshuar asnjë prokurë apo akt tjetër përfaqsimi në gjykim. Kërkuesi nuk ka dhënë asnjë deklaram përpara organeve proceduese dhe nuk provohet te kete patur dijeni për ankimin e vendimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkuesi Izet Haxhia gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë në Turqi nën mbikqyrjen e vazhdueshme të autoritetetve shtetërore Turke deri në momentin e ekstradimit të tij në Shqiperi më dt.08.05.2018.

Në vendimin unifikues të gjykates se larte Nr.2 date 28/05/2002 parashikon ne menyre taksative që në gjykimin e ceshtjes në mungese të të pandehurit për shkak se ky i fshihet gjykimit, të drejten për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit dhe të drejtën për të bërë ankim kundër vendimit në një gjykate me te larte e ka vetem i pandehuri ose nje mbrojtes i caktuar prej tij me prokurë.

Ky vendim unifikues ka dale para se te gjykohej ceshtja në apel, rreth dy muaj më pare, si rrjedhoje, avokati i caktuar nga familjaret nuk legjitimohej te bente ankim ndaj vendimit të gjykates shkalles pare e për rrjedhojë, gjykata e Apelit nuk munde ta shqyrtonte ceshtjen, por duhej të vendoste mospranimin e ankimit pasi nuk është bërë nga personi i legjitimuar. Ky element juridik është përcaktuar edhe ne nenin 410 te K.Pr.P. ku parashikohet se ankimi mund të bëhet nga vete i pandehuri ose mbrojtesi i tij. Në nenin 415 të K.Pr.P. është parashikuar se afati i ankimit ka qene 10 dite ( me ndryshimet e vitit 2017 15 dite) dhe ky afat fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit

ose e njoftimit te tij. Nga kjo dispozite del qarte se vendimi i gjykates , në rastet kur i pandehuri është në mungese duhet ti njoftohet nga organi procedues me qëllim që të ushtroje të drejtën e ankimit. Ky njoftim duhet te behet nga organi procedues, nga gjykata qe ka dhene vendimin. Asnje vendim nuk mund të marre forme të prere në se nuk është konfirmuar marrja dijani.

Sipas pretendimeve të prokurorit, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, kërkuesi nuk arriti të provoje se kërkesa për rivendosje në afat është bërë brenda 10 diteve nga marrja dijani sic parashikon neni 147/3 e K.Pr.P.

Ky pretendim i prokurorise nuk është i bazuar në ligj. Nuk është detyre e kërkuesit të provoje se kërkesa është paraqitur brenda 10 diteve por është detyrë e shtetit të provoje daten se kur i ka njoftuar vendimin e më pas, nga fillimi i kësaj date llogaritet afati 10 ditor, pa qenë e nevojshme për ndonjë prove tjetër. E vetmja prove për të përcaktuar këtë afat, është dokumenti i njoftimit të vendimit të denimit, të cilin është i detyruar ta paraqes organi që përfaqeson shtetin dhe jo individi. Por sic rezulton nga aktet, nuk ka asnjë dokument ku gjykata apo prokuroria ti kete dorezuar kopjen e vendimit të denimit kërkuesit Izet Haxhija.

Nga aktet rezulton se me shkresen Nr. 10/26/1 date 05/06/2006 Interpol Ankara ka njoftuar se me daten 03.06.2006 është arrestuar me qëllim ekstradimi drejt vendit tonë shtetasi Izet Haxhija. Referuar shkreses Nr. 1255KL/5 Prot. Date 4.11.2010 të Ministrise Brendeshme , zyrës qëndrore kombetare të Interpol Tirana, rezulton se ky person është shpallur në kërkim ndërkombëtar më daten 03/02/2001 edhe është arrestuar me qëllim ekstradimi me daten 4/06/2006 . Sic rezulton nga keto akte, në momentin e arrestimit nga Interpol Ankara, atij nuk i është njoftuar vendimi i denimit të gjykates Shqiptare, por vendimi për caktimin e mases së sigurimit arrest në burg. Kjo del qarte nga data e kërkesës për kerkim ndërkombetar dt. 03/02/2001 ndërsa vendimi i denimit është shpallur me daten 29/04/2002 (dhe me daten 09/07/2002 i gjykates Apelit Tirane.)

Sa me siper, kerkuesit Izet Haxhia nuk i është komunikuar vendimi penal Nr. 316 date 29/04/2002. Megjithatë, në aktet nuk ka asnje lloj tjetër informacioni ku të vërtetohet marrja dijani e vendimit të denimit te gjykates shkalles pare Tirane me qellim që të llogaritej afati 10 ditor për tu rivendosur në afat.

Sa më siper, kjo gjykate e gjen te bazuar kerkesen e paraqitur nga kerkuesi, se ajo është paraqitur brenda afatit 10 ditor.

Legjislacioni shqiptar në mbeshtetje të konventave ndërkombëtare, ka mbajtur një qëndrim konseguent lidhur me gjykimet në mungese. Në nenin 491/f te K.Pr.P. shteti yne nuk pranon asnje kerkese për ekstradimin e shtetasve në se ai është gjykuar në mungesë me përjashtim të rastit kur shteti kerkues jep garanci për rishikimin e vendimit. Në analogji dhe reciprocitet me kete parim, cdo shtetasi që ekstradohet pë në Republikën eShqiperise, kur ai është gjykuar në mungesë e jepet e drejta e rishikimit të vendimit.

Por, fakti se kërkuesi ka kërkuar rivendosjen ne afat dhe jo rishikim

nuk cenon parimin themelor të dëgjimit të personit gjate procesit gjyqesor qe zhvillohet kundër tij. Ne fund te fundit, si apeli, rekursi apo rishikimi, jane tre format e ankimit që parashikohen nga neni 407/3 te K.Pr.P. Eshtë e drejta e të pandehurit të zgjedh mjetin e ankimit pa kapërcyer shkallët e gjykimit. Në rastin konkret, kërkuesi ka zgjedhur të rivendoset në afat për tu ankuar ndaj vendimit të gjykates shkalles pare.

Kjo e drejtë nuk mund ti cenohet pasi ceshtja do të gjykohet në një gjykate me të larte , në gjykatën e Apelit e cila ka te gjitha tagrat, qofte per te vendosur mospranimin e ankimit në se nuk është berë në përputhje me ligjin, ashtu edhe per ta persëritur gjykimin e shkalles se pare qoftë plotësisht apo pjesërisht, e thene ndryshe, kerkuesi nuk kerkon te shmanget nga gjykimi por të dëgjohet e të vendoset perseri për te nga nje gjykate e caktuar me ligj.

Në sintheze sa më siper, Gjykata konkludon që kërkuesi Izet Haxhia i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 147 e 420/1 te K.Pr.Penale per t'u rivendosur në afatin e ankimit ndaj Vendimit penal Nr.316, date 29.04.2002 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi mosrealizimi i të drejtës së ankimit nga i denuari dhe mbrojtësi i zgjedhur prej familjarëve të tij, rezulton të kete ndodhur për shkaqe bindese e madhore, kërkesa duhet pranuar pasi është e mbështetur në ligj dhe në prova.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 147, 379 të KPr.P.

#### V E N D O S I

Pranimin e kerkesës.

Rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, të kërkuesit Izet HAXHIA, për vendimin Nr.316 dt. 29.04.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë , lënë në fuqi me vendimin Nr.351 dt.09.07.2002 të Gjykatës Apelit Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kerkuesit.

Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot neTiranë, me datë 21.06.2018

SEKRETARE

GJYQTA

R

Florinda NUSHI

Besnik

HOXHA